



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë,

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr. 317 Prot.

Tiranë, më 01.04.2016

V E N D I M

Nr. 31, datë 01.04.2016

“Për përfundimin e procesit të mbikëqyrjes në lidhje administrimin e shërbimit civil në institucionin, Instituti i Zhvillimit të Arsimit”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 80-104, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të Relacionit të Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë “Mbi verifikimin e ekzekutimit të vendimit nr. 61, datë 30.06.2015 “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Institutin e Zhvillimit të Arsimit”, në lidhje me procesin e mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, të zhvilluar në institucionin, Instituti i Zhvillimit të Arsimit,

Vërej se:

Në zbatim të Vendimit nr. 30, datë 23.03.2015, “Për kryerjen e mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në Institutin e Zhvillimit të Arsimit”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është realizuar mbikëqyrja në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, pranë këtij institucioni.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr. 61, datë 30.05.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në Institutin e Zhvillimit të Arsimit”, në të cilin është vendosur:

1. Të miratojë raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Institutin e Zhvillimit të Arsimit, i cili është pjesë e këtij vendimi.

2. Nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore dhe Departamentit të Administratës Publike, duhet të mbahen parasysh rekomandimet e Komisionerit, në lidhje me institutin e vlerësimit të punës, të cilat janë të materializuara në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes, me qëllim që ky proces të kryhet në përputhje me procedurat ligjore dhe për të evituar subjektivizmin në nivelin e vlerësimit.
3. Nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore dhe Departamentit të Administratës Publike, duhet të mbahen parasysh rekomandimet e Komisionerit, në lidhje me institutin e përshkrimit të punës, të cilat janë të materializuara në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes, me qëllim që ky proces të kryhet në përputhje me procedurat ligjore, për të mundësuar verifikimin dhe administrimin e formularit të përshkrimit të punës nga Departamenti i Administratës Publike.
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim.

Me kalimin e afatit procedural, prej 30 ditësh, Komisioneri vendosi kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim, për të verifikuar ecurinë e zbatimit të vendimit, procedurë e bazuar në nenin 14, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe në Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit.

Kjo procedurë ka filluar me Urdhrin nr. 188, datë 24.02.2016, të Komisionerit, me anë të të cilit është ngritur grupi i punës, i cili është ngarkuar për t'u paraqitur në subjektin e mbikëqyrjes dhe për të verifikuar nivelin e zbatimit të vendimit paralajmërues.

Në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me institutin e vlerësimit të punës dhe me atë të përshkrimit të punës, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka rekomanduar si më poshtë:

- Depozitimi i përshkrimeve të punës në Departamentin e Administratës Publike dhe miratimin apo jo nga ky i fundit, nëqoftëse vëren se ato nuk janë të hartuara në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standart të miratuar, detyrim ky i parashikuara në pikën 19 dhe 20 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” dhe Udhëzimit nr.2, datë 07.04.2014, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.
- Në drejtim të përsosjes së procesit dhe të eliminimit të vlerësimeve subjektive, duhet që eprorët të mbajnë shënime periodike për arritjet e nëpunësve civilë gjatë vitit të vlerësimit. Konkluzioni i mësipërm ka ardhur si rezultat i konstatimit, që të gjithë nëpunësit, për vitin 2014, vlerësimin e rezultateve në punë e kishin në nivelin *shumë mirë* (1).

Bazuar në urdhrin e mësipërm, grupi i punës u paraqit në subjektin e mbikëqyrur në datën **24.02.2016** dhe i kërkoi personit përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore, specialistes *****, dosjet e personelit, si dhe çdo akt tjetër administrativ, të nevojshëm për të verifikuar zbatimin e vendimit.

Në përfundim të verifikimit, rezultoi se njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore kishte kryer veprimet e domosdoshme për:

- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 2 të pjesës urdhëruese të vendimit nr. 61, datë 30.06.2015, të Komisionerit, rezultoi se, vlerësimet e punës ndodheshin në dosjet përkatëse dhe në vlerësimet e vitit 2015, ishin reflektuar rekomandimet e Komisionerit në lidhje me vlerësimet e nëpunësve civilë (*13 nëpunës ishin vlerësuar në nivelin shumë mirë (1), ndërsa 11 nëpunës ishin vlerësuar në nivelin mirë (2)*), sipas përcaktimeve të nenit 62, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” dhe Vendimit nr.109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”.
- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 3 të pjesës urdhëruese të vendimit nr. 61, datë 30.06.2015, të Komisionerit, rezultoi se, përshkrimet e punës së nëpunësve janë realizuar në përputhje me Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”. Me shkresën nr. 391, datë 24.07.2015, përshkrimet e punës i janë dërguar Departamentit të Administratës Publike me qëllim verifikimin dhe miratimin e tyre, detyrim ky i parashikuar në pikën 19 dhe 20 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, por nga ky i fundit nuk kishte përgjigje.

Sa më sipër, u verifikua reagimi i njësisë përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes dhe u mbajt procesverbali i konstatimit. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil konstatoi se Vendimi nr. 61, datë 30.05.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në Institutin e Zhvillimit të Arsimit”, është zbatuar plotësisht, nga ana e subjektit, **Instituti i Zhvillimit të Arsimit**.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procesit të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në institucionin, Instituti i Zhvillimit të Arsimit.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 61, datë 30.05.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në Institutin e Zhvillimit të Arsimit”.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Departamenti i Administratës Publike

dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA